



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 14 korrik 2014  
Nr. ref.: RK676/14

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI71/14**

Parashtrues

**Asllan Bahtiri**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, të 4 marsit 2014**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Asllan Bahtiri (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, të 4 marsit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 prill 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, të 4 marsit 2014, i cili sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, kishte shkelur nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 14 prill 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 maj 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI71/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI71/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 23 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën lidhur me kërkesën e tij për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë për pretendimet e ngritura kundër tij.
9. Më 26 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI71/14, e zëvendësoi gjyqtaren Snezhana Botusharova kryesuese të Kolegjit shqyrtues dhe në vendin e saj caktoi gjyqtarin Altay Suroy. Me të njëjtin vendim, Kryetari i Gjykatës e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si anëtar të Kolegjit shqyrtues dhe në vend të tij caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova.
10. Më 26 qershor 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

## Përmbledhja e fakteve

11. Më 4 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës kishte aplikuar në konkursin e publikuar lidhur me ndarjen e banesave në Komunën e Prishtinës, të cilat Komuna i jep me qira për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejme: UÇK).
12. Më 18 maj 2012, Komisioni për dhënien e banesave me qira i Komunës së Prishtinës për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së, kishte shpallur në tabelën e shpalljeve listën e përfituesve të banesave, në të cilën nuk ishte radhitur parashtruesi i kërkesës.
13. Më 21 maj 2012, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë me numër 02.360-4965/1, kundër "Listës prioritare" të publikuar në tabelën e shpalljeve.
14. Më 2 korrik 2012, me Vendimin e shkallës së dytë të Komisionit për shqyrtimin e ankesave, nr. 02-360-4965/2012, të 2 korrikut 2012, është refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe është vërtetuar vendimi i komisionit të shkallës së parë për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve përfituese të banesave të dedikuara për familjet e dëshmorëve dhe të invalidëve.
15. Më 12 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi për anulimin e Vendimit administrativ të shkallës së dytë të Komisionit për shqyrtimin e ankesave, nr. 02-360-4965/2012, të 2 korrikut 2012.
16. Më 1 tetor 2013, duke vendosur lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, me Aktgjykimin A. nr. 1332/2012, të 1 tetorit 2013, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi i së paditurës, Komunës së Prishtinës – Komisionit për ndarjen e banesave, nr. 02-360-4965/2012, të 2 korrikut 2012, me arsyetimin si në vijim:

*"... Nga dëshmitë e nxjerra nga Komisioni gjatë vizitës së paditësit si dhe dëshmimeve të dorzuara në aplikacion, kanë konstatuar se i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet për ndarje të banesës dhe se nuk ka marrë numër të mjaftueshëm të pikëve nga shkaku se është vetëm një anëtarë dhe nuk ka arrit pikët e mjaftueshme për tu ranguar në listën e fituesve të banesave..."*
17. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A. nr. 1332/2012, të 1 tetorit 2013, parashtruesi i kërkesës me kohë ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.
18. Më 4 mars 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me Aktgjykimin AA. nr. 404/2013, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A. nr. 1332/2012, të 1 tetorit 2013, me arsyetimin si në vijim:

*"... Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërsi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për*

*konfliktin administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 49 të LKA-së. Sa i përket pretendimeve ankimore të paditëses se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të s paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së...”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“i është shkelur e drejta në mbrojtje gjyqësore të të drejtave nga neni 54 i Kushtetutës, sepse gjykatat nuk kanë vlerësuar drejtë kërkesën e ankuesit”.*
20. Në bazë të tërë asaj që është paraqitur në këtë kërkesë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që:

*“Të vlerësohet që i është shkelur e drejta në ndarjen e banesës, si nga Komuna e Prishtinës, ashtu edhe nga gjykatat”.*

*“Nuk është respektuar Rregullorja dhe nuk është vlerësuar ligjshmëria nga gjykatat”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

21. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

23. Gjykata i referohet edhe nenit 48. të Ligjit, i cili parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

24. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*...*

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese“.

25. Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale dhe të Rregullores së Komunës lidhur me mënyrën e vlerësimit, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr 30544/996, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
26. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A. nr. 1332/2012, i 1 tetorit 2013, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, i 4 marsit 2014, në arsyetimet e tyre shpjegojnë në detaje arsyet për zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale si dhe mënyrën e vlerësimit sipas rregullores në procesin e ndarjes së banesave dhe u japin përgjigje këtyre pretendimeve të parashtruesve të kërkesës.
27. Gjykata Kushtetuese thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
28. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Komisionit të Komunës së Prishtinës për ndarjen e banesave, Komisionit për shqyrtimin e ankesave, Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064, i 30 qershorit 2009).
29. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të theksojë dhe të mbështesë me dëshmi pretendimet se me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
30. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 26 qershor 2014, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Robert Carolan



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani